



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 9 Datë 13. 06. 2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “Albania Tourist Resort ” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) te subjektit “Albania Tourist Resort” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V e n d o s i:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “Albania Tourist Resort” SH.P.K me administrator Znj. Ana SHTJEFNI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Gagut**, degë e Lumit të Shalës për prodhim energjie elektrike në fshatin Gimaj, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC GAGU do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 43 96 594.378 ; Y - 46 88 803.170 ; Z - + 800 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 43 99 145.600 ; Y - 46 88 385.747 ; Z - + 400 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 43 99 145.600 ; Y - 46 88 385.747 ; Z - + 400 m

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 0.15 m<sup>3</sup>/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0.15 m<sup>3</sup>/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.01125 m<sup>3</sup>/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 0.15 m<sup>3</sup>/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**



**KRYETAR**

